



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 588/9 Prot.

Tiranë më 03.01.2017

V E N D I M

Nr. 8, datë 03.01.2017

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin nr. 588/2 prot., datë 30.09.2016, për verifikimin e ligjshmërisë së transferimit të nëpunëses ***.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 77 e vijues, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit nr. 13 prot., datë 13.01.2017, dhe mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, lidhur me ligjshmërinë e veprimit administrativ të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për transferimin e përkohshëm në detyrë, të nëpunëses *****.

V ë r e j s e :

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, të filluar me urdhrin nr. 588/2 prot., datë 30.09.2016, "Për verifikimin e informacionit të ardhur nga punonjësja *****, në lidhje me transferimin e përkohshëm në detyrë", rezulton se, shkak për fillimin e kësaj procedure është bërë një kërkesë e paraqitur prej nëpunëses në fjalë, protokolluar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 588 prot., datë 23.09.2016, në të cilën ngrihet pretendimi se transferimi nga detyra e mëparshme "Drejtore i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore" në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Investimeve dhe Logjistikës", është bërë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në nenin 50 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil".

Duke shqyrtuar këtë dokumentacion, konstatohet se nëpunësja ***** është emëruar në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, me vendimin nr. 17535 prot., datë 16.10.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave. Pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, me aktin nr. 8537/76 prot., datë 07.04.2015, Njësia Përgjegjëse (*Departamenti i Administratës Publike*), ka bërë deklarin e statusit të punësimit dhe më tej, për këtë nëpunëse, pas përfundimit të periudhës së provës dhe përmbushjes së detyrimeve që përmban kjo fazë, me Vendimin nr. 14546 prot., datë 12.06.2015, është bërë konfirmimi “nëpunës civil”, në pozicionin e mësipërm të punës.

Shkaku i kësaj mosmarrëveshje që është bërë objekt i hetimit administrativ, është fakti që Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, me urdhrin nr. 22091 prot., datë 19.09.2016, “Për transferimin të përkohshëm në detyrë”, me pretendimin e kryerjes së një riorganizimi më efikas dhe të përshtatshëm të punës, ka urdhëruar transferimin e përkohshëm të nëpunëses në fjalë, nga pozicioni i punës “Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Investimeve dhe Logjistikës”, në Drejtorinë e Burimeve Mbështetëse, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duke urdhëruar me këtë rast edhe ndryshimin e kategorisë së pagës, nga ajo që i përgjigjet nivelit të nëpunësisë “A”, në nivelin “B”.

Gjatë kohës që po zhvillohej hetimi administrativ, konstatohet se vetë institucioni, me urdhrin nr. 22091/1prot., datë 23.09.2016, ka ndryshuar aktin e mëparshëm të transferimit të përkohshëm, duke shtuar pikën 3/1, me përmbajtje si më poshtë:

“Të bëhet pagesa e diferencës që i takon nga kategoria “B” në “A”, për periudhën prej datës 19.09.2016 e në vijim”.

Në referencë të neneve 87 dhe 88, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në zbatim të së drejtës për të dhënë sqarime, gjatë hetimit administrativ, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me aktin nr. 23080/3 prot., datë 10.10.2016, ka informuar Komisionerin për veprimet administrative që janë kryer për transferimin e përkohshëm të nëpunësen ***** , si dhe bazën ligjore të këtyre veprimeve.

Sipas pretendimeve të institucionit, ky transferim është bërë për të rritur eficiencën në punë, bazuar në nenet 13/3 dhe 15/7, të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dispozita të cilat ndër të tjera, përcaktojnë se transferimi lejohet të bëhet në një nga departamentet e D.P. Doganave, në degët doganore apo pranë strukturave të tjera ku atashohen, sipas ligjit, punonjës doganorë.

Më tej, institucioni, nëpërmjet Urdhrit nr. 26295 prot., datë 10.11.2016 “Për rikthim në detyrën e mëparshme”, ka rikthyer nëpunësen ***** në pozicionin e mëparshëm të punës.

Nga ana tjetër, nëpërmjet shkresës nr. 588/8 prot, datë 30.11.2016, të nëpunëses ***** , është njoftuar Komisioneri, se nga ana e saj nuk ka pretendime lidhur me këtë çështje, pasi marrëdhënia e saj e punës aktualisht vijon në përputhje me ligjin.

Nga gjithë sa u parashtrua më sipër, arrihet në përfundimin se gjendja e ligjshmërisë është rivendosur, kështu që nuk është e nevojshme ndërhyrja apo investimi i mëtejshëm i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këtë arsye :

Bazuar në nenin 90, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 34, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, të nisur me urdhrin e verifikimit nr. nr. 588/2 prot., datë 30.09.2016, “Për verifikimin e informacionit të ardhur nga punonjësja *****, në lidhje me transferimin e përkohshëm në detyrë”, pasi nga ana e institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave janë kryer veprime administrative të cilat kanë rivendosur gjendjen e ligjshmërisë.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti i Administratës Publike dhe kërkuesja *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA